



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr.526/7 Prot.

Tiranë, më 07.11. 2016

V E N D I M

Nr. 115, datë 07.11.2016

“Mbi verifikimin e ligjshmërisë të aktit nr. 32, datë 22.07.2016, të Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale Dibër, për lirimimin nga shërbimi civil të nëpunëses ***”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, neneve 77-89, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Dibër, për rastin e nëpunëses *****,

VËREJ SE :

Mbi bazën e informacionit të përcjellë nëpërmjet një kërkesë nga punonjësja ***** , regjistruar, me nr. 526 prot., datë 29.08.2016, Komisioneri ka nxjerrë urdhërin e verifikimit, nr. 526/1 prot, të datës 02.09.2016, për të kryer veprime të mëtejshme për të sqaruar problemin e ngritur në këtë rast, i cili ka të bëjë me parregullsi të pretenduara, se janë kryer gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Në zbatim të këtij akti, u krye hetimi i plotë administrativ i këtij rasti, u administrua dokumentacioni i nevojshëm dhe më pas, u krye vlerësimi i ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe Drejtori i Drejtorisë Arsimore Rajonale Dibër, në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, për punonjësen ***** , në pozicionin e punës “Specialiste e Burimeve Njerëzore”, në Drejtorinë Arsimore Rajonale, Dibër.

Nga analiza e akteve të administruara rezulton se, nëpunësja ***** ka filluar punë në Drejtorinë Arsimore Rajonale Dibër, me aktin e emërimit të Departamentit të Administratës Publike nr. 5809, datë 23.11.2015, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, si nëpunëse civile

në periudhë prove, në pozicionin *“Specialiste e Burimeve Njerëzore”*, në Sektorin e Programeve të Zhvillimit.

Gjatë vazhimit të periudhës së provës, me aktin nr. 31, dt. 18.07.2016, *“Për fillimin e ecurisë disiplinore”*, të drejtuesit të Drejtorisë Arsimore Rajonale Dibër, ndaj kësaj nëpunëseje, ka filluar një ecuri disiplinore, me motivacionin për moszbatim të dispozitave ligjore në përmbushje të detyrave funksionale, procedurë e cila i është bërë e ditur, sipas urdhërimit të pikës 2, të këtij akti.

Më pas, me Vendimin nr. 32, dt. 22.07.2016, *“Dhënie mase disiplinore, për largim nga detyra, për shkak të mos zbatimit haptazi të dispozitave ligjore në përmbushje të detyrave funksionale”*, drejtuesi i DAR, Dibër, ka vendosur largimin nga detyra për këtë punonjëse.

Kërkuesja ka ngritur pretendimin se akti i marrjes së masës disiplinore ndaj saj është realizuar në tejkalim të kompetencave dhe në shkelje të procedurave të parashikuara prej ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil” i ndryshuar*, si dhe të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*.

Në lidhje me këtë pretendim, nga ana e institucionit parashtrohet se procedurat e parashikuara nga dispozitat e sipërpërmendura janë mbajtur parasysht, duke e bazuar këtë në faktin se me urdhrin nr. 20, dt. 18.07.2016, *“Për krijimin e Komisionit disiplinor”*, Drejtori i DAR, Dibër, ka urdhëruar ngritjen e Komisionit Disiplinor të përbërë nga 3 anëtarë, për të shqyrtuar shkeljet disiplinore që pretendohet se janë kryer nga nëpunësja e proceduar. Më tej pretendohet se, pas shqyrtimit të çështjes nga ana e këtij komisioni, Drejtori i DAR, Dibër, me Urdhrin nr. 32, dt. 22.07.2016, *“Për marrjen e masës largim nga detyra”*, ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për nëpunësen *****.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar arrihet në përfundimin se, në kryerjen e veprimit administrativ, nuk janë mbajtur parasysht kërkesat e ligjit për zhvillimin e një procedimi disiplinor, duke kryer/lejuar shkelje të dukshme të procedurës së përcaktuar në nenet 57, deri 60, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil” i ndryshuar*, Vendimit nr. 115, datë 05.03.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*, si dhe të gërmës a) dhe d) të nenit 109, të ligjit 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*.

Konkretisht, përbërja e Komisionit Disiplinor në këtë rast, është në kundërshtim me përcaktimin e pikës 3, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil” i ndryshuar*, dhe Kreut I, pika 2, të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*. Sipas kësaj dispozite, Komisioni i Disiplinës duhet të jetë i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, duke përcaktuar edhe cilësinë e pjesëtarëve të tij në hierarkinë administrative të shërbimit civil. Po kështu, përmendet posaçërisht qenia në përbërjen e Komisionit të Disiplinës e një përfaqësuesi të Departamentit të Administratës Publike. Ndërkohë, në rastin në fjalë Komisioni përbëhet vetëm nga tre anëtarë, punonjës të institucionit që nuk plotësojnë ato karakteristika që kërkon pika 2, e Kreut I, të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2015, të Këshillit të

Ministrave “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” siç janë, nëpunësi më i lartë civil i institucionit, eprori direkt i nëpunësit për të cilin ka filluar ecuria disiplinore, etj.

Qenia në përbërjen e komisionit disiplinor e përfaqësuesit të DAP, është e detyrueshme, me qëllim që ky i fundit të ushtrojë kompetencën e tij për monitorimin dhe kontrollin e shërbimit civil, në administratën shtetërore në përgjithësi dhe mirëfunksionimin dhe zbatimin e drejtë të procedurës ligjore nga ana e Komisionit të Disiplinës.

Nga ana tjetër, vendimi për lirimin nga shërbimi civil për nëpunësen *****, nuk është marrë nga Komisioni i Disiplinës, por nga drejtuesi i Drejtorisë Arsimore Rajonale Dibër, ç’ka në kuptim të procedurës administrative, përbën veprim në tejkalim të kompetencës. Po kështu, parregullsi e dukshme është edhe mosrespektimi i afateve që parashikohen prej germës ”ç”, të pikës 13, të Vendimit nr. 115 dt. 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, të cilat garantojnë nëpunësin për njohjen me materialet që e ngarkojnë me përgjegjesi, për të drejtën për tu mbrojtur, për tu dëgjuar, për të paraqitur prova, dëshmitarë, etj.

Përfundimisht, jemi para rastit kur konstatohet shkelja e procedurës në nxjerrjen e aktit për lirimin nga detyra të nëpunëses së sipërpërmendur, si në aspektin e përbërjes së Komisionit të Disiplinës, e cila vjen në kundërshtim me ligjin material, (neni 59, pika 3, e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar) ashtu dhe në aspektin e kapërcimit të kompetencës së organit publik që ngarkohet nga ligji për marrjen e masës disiplinore, shkelje këto që parashikohen nga pikat i) dhe ii), të germës a) të nenit 108 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” dhe pasjellin pavlefshmëri absolute të aktit.

Ekzistenca e këtyre shkeljeve të parashikuara nga neni 108, i ligjit të sipërpërmendur, në bazë të nenit 111, të atij ligji, duhet të konstatohet në mënyrë detyruese nga ana e organit publik që ka nxjerrë aktin, nga ana e organit epror të tij, apo e organit që ka për detyrë kontrollin dhe monitorimin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe shërbimit civil.

Një akt i tillë (pra, një akt absolutisht i pavlefshëm), në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston, prandaj si i tillë, ai duhet anuluar. Anulimi i tij, në bazë të nenit 113, pika 2, të ligjit në fjalë, bën që të anulohen pasojat edhe për të shkuarën, kështu që problemi/mosmarrëveshja duhet të kthehet nga pikëpamja procedurale, në pikën fillestare.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14, 15 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenet 108 pikat i) dhe ii), të germës a), 110, pika 1, neni 111 dhe neni 113, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”; neni 35 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, ndjekjen e procedurës për anulimin e aktit nr. 32, datë 22.07.2016 të Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale, Dibër, për lirim nga detyra të nëpunëses *****, si akt absolutisht i pavlefshëm.

Procedura e ecurisë disiplinore të përsëritet edhe një herë nga organi kompetent, duke respektuar gjithë kërkesat e ligjit material dhe procedural për kryerjen e këtij veprimi administrativ.

2. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër dhe kërkuesja *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA